

Z. Adhurim Banushaj, ka përfunduar studimet e larta në periudhën 2002-2007, pranë Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali” Fakulteti I Ekonomisë, Dega Administrim Biznesi.

Ai ka një eksperiencë prej rreth 10 vitesh në sektorin privat (2007-2017), ku ka ushtruar profesionin e menaxherit dhe ekonomistit për disa operator ekonomikë.

Në vitet 2017-2022, ka ushtruar detyrën e Inspektorit të Antikorrupsionit dhe Krimin Ekonomik pranë SHISH.

Z. Banushaj ka filluar punë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit që nga Prilli 2023 e në vazhdim. Ka mbajtur pozicione pune si, Auditues I dhe Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, ndërsa aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Sigurisë Etikës dhe Integritetit në KLSH.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si: luftës kundër pastrimit të parave, diagnostikimin dhe menxhimin e rrezikut të korrupsionit ne prokurimet publike, menaxhim projektsh si dhe në një sërë konferencash ndërkombëtare me institucionet homologe të KLSH. Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin

Z.Banushaj është njohës i mirë i gjuhës angleze dhe italiane